



Gjermanishtja si gjuhë e dytë: Informacion për prindërit.

Të dashur prindër!

Njohuritë e gjuhës gjermane janë me rëndësi, që një fëmijë në shkollë të mësojë me sukses. Fëmijët, që gjuhën gjermane nuk e kanë si gjuhë të parë, marrin në rast nevojë, një mësim në gjermanisht si gjuhë të dytë (Deutsch als Zweitsprache (DaZ)).

Unë dëshiroj që t'ju informoj Ju mbi këtë, se fëmija juaj do të marrë mësim në DaZ. Qëllimi është, që fëmija juaj të mësojë gjermanishten letrare, kështu që ai të mund të ndjekë mësimin në shkollë.

Së shpejti do t'ju ftoj me shumë dëshirë, për një bisedë në lidhje me rezultatet e fëmijës tuaj në gjermanishten letrare. Unë do të gëzohesha shumë, në qoftë se ju do të vizitonit edhe mësimin DaZ, në një nga orët e mëngjesit. Pasi të na keni kontaktuar, jeni të mirëpritur edhe në një orar tjetër.

Jeni të lutur, që mësimin e gjermanishtes të fëmijës tuaj, ta përkrahni në mënyrë aktive, për shembull duke e motivuar fëmijën ose duke u kujdesur që fëmija juaj, jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë saj, të ketë shumë kontakte më fëmijë gjermanisht-folës si dhe të lexojë libra në gjermanisht.

Gjithashtu i rëndësishëm për fëmijën është edhe kujdesi nga ana juaj për ruajtjen edhe pasurimin e gjuhës tuaj. Lëreni atë që në gjuhën familjare të tregojë për shkollën dhe ndihmojeni në qoftë se ai nuk di ndonjë fjalë. Është një shans që i është dhënë fëmijës suaj, të rritet dy gjuhësisht.

Për sqarime të mëtejshme jemi në dispozicionin tuaj.

Me respekt
Mësuesja e DaZ-it/ Mësuesi i DaZ-it:

.....
Emri, Shkolla, Telefoni